



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Direkcija za Opštu Upravu/Department of General
Administration



02.Nr-106/02-31616/24

Datë: 17.12.2024

R A P O R T

I PËRMBUSHJES SË PLANIT TË INTEGRITETIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2023

DHJETOR 2024

Përbajtja

HYRJE	3
Auditimi i brendshëm	4
Prokurimi publik	4
Administrata Komunale.....	5
Mospërputhja e funksioneve	6
Deklarimi i pasurive	7
Kabineti i Kryetarit	7
Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve	7
Inspektimi.....	8
Urbanizmi dhe Planifikimi.....	9
PËRMBLEDHJE	9

HYRJE

Në çdo organizatë buxhetore e gjithashtu edhe në Komunën e Kaçanikut, Plani i Integritetit është një mjet për menaxhimin e rrezikut të korruptionit dhe rreziqeve të tjera të cilat dëmtojnë imazhin dhe integritetin e organizatës.

Çdo aktivitet i përditshëm i institucionit komunal përfshin rreziqe të caktuara dhe pavarësisht se çfarë bëjmë ne, kur përqendrohemë në detyrat tona të punës, ne mund të ekspozohemi me ose pa vetëdije me rreziqet të cilat janë paraparë se mund të ndodhin. Prandaj, pikërisht hartimi i Planit Komunal për Integritet 2022-2026, është një mundësi për t'iu kushtuar më shumë kohë rreziqeve, ndërsa dokumenti i miratuar mundëson një pasqyrë të përhershme të rreziqeve me të cilat ne i kemi paraparë gjatë hartimit.

Sistemi bashkëkohor i qeverisjes së mirë kërkon që lidershipi dhe personeli t'i identifikojnë ato rreziqe; të hartojë masa për eliminimin e rreziqeve ose zvogëlimin e mundësisë së shfaqjes së tyre, për t'i analizuar këto masa në mënyrë të vazhdueshme dhe për të raportuar për to.

Prandaj, në Planin Komunal për Integritet 2022-2026, fushat e rreziqeve janë ndarë në dy pjesë:

1. Në fushat specifike të rrezikut (Prokurimi publik; Administrata Komunale; Konflikti i interesit; Mospërputhja e funksioneve; Deklarimi i pasurive; Kabineti i Kryetarit; Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve; Inspektimi; Urbanizmi dhe planifikimi; Edukimi dhe kultura; Shëndetësia dhe mirëqenia sociale dhe Bujqësia dhe zhvillimi rural) dhe

2. Në fushat e përgjithshme të rrezikut

Raporti në vazhdim do t'i shtjellojë çështjet më të rëndësishme (kryesore) të rreziqeve specifike të implementimit të Planit Komunal për Integritet 2022-2026 përkatsisht për vitin 2023.

Auditimi i brendshëm

Zyra e Auditimit të Brendshëm, ose Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit dhe aktiviteteve të NJAB-së. Ajo siguron përdorimin produktiv, ekonomik dhe efikas të burimeve të njësisë, duke garantuar gjithashtu zbatimin e duhur dhe respektimin e ligjeve, rregulloreve, politikave, udhëzimeve dhe manualeve të miratuara. Njëkohësisht, sigurohet që planet përkatëse të përgatiten dhe dorëzohen në kohë, ndërsa organizon, drejton dhe mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm nga NJAB, duke paraqitur rezultatet e auditimit para Komisionit të Auditimit të organizatave buxhetore ose ndërmarrjeve publike autonome.

Njësia gjithashtu përgatit dhe dorëzon raporte gjashtëmujor dhe vjetor mbi aktivitetet e auditimit te Komisioni i Auditimit të organizatave buxhetore ose ndërmarrjeve publike autonome. Ajo realizon auditime të brendshme në përputhje me rregullat, politikat, udhëzimet dhe standardet profesionale të përcaktuara nga Ministria përkatëse. Për më tepër, ajo merr dhe shqyrton të dhënat teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe dokumentacionin e mbajtur nga subjekti i auditimit në sektorin publik. Në kuadër të auditimit, NJAB mund të kopjojë të dhëna dhe dokumente për qëllime të auditimit dhe siguron që kopjet të janë autentike.

Njësia ka të drejtën të kërkojë informacione nga çdo zyrtar, punonjës, këshilltar apo kontraktues i subjektit të auditimit për të ofruar dëshmi fizike, shënime, dëshmi gojore ose informata të tjera që lidhen me aktivitetet që po auditohet. Po ashtu, ka qasje të pakufizuar në objektet e subjektit të auditimit dhe mund të verifikojë dhe vlerësojë pasuritë materiale dhe monetare në përputhje me legjispcionin dhe rregullat përkatëse. Në fund, ajo propozon masat që duhet të merren nga subjekti i auditimit për përmirësimin e gjendjes.

Duke u bazuar në këto përgjegjësi, auditimi i brendshëm i planifikuar ka identifikuar disa rreziqe kryesore si: kapacitete të pamjaftueshme të njësisë së auditimit të brendshëm, praktika të dobëta të menaxhimit të auditimit dhe pavarësi të pamjaftueshme të njësisë. Megjithatë, gjatë përgatitjes së raportit gjashtëmujor, nuk janë vërejtur shkelje të cilat mund të lidhen me aktivitetet e kësaj zyre.

Prokurimi publik

Zyra e Prokurimit ka përgjegjësinë për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të mëposhtme: Zbatimin e ligjit dhe legjispcionit të Prokurimit Publik; Sigurimin që prokurimet publike të realizohen në mënyrë efikase, efektive, transparente dhe në përputhje me parimet e shfrytëzimit të drejtë të fondeve dhe burimeve publike; Sigurimin e integritetit dhe përgjegjësisë së individëve që janë të përfshirë në aktivitete të prokurimit publik; Promovimin e trajtimit të barabartë dhe krijimin e një tregu të hapur të prokurimit, duke ndihmuar në zhvillimin e një kulture profesionale dhe të pandikuar nga interesat personale për organet publike; Zbatimin e rregullave të prokurimit që mbështeten në parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues.

Zyra e Prokurimit siguron zhvillimin e transparencës, e cila është një nga instrumentet kryesore të kontrollit, duke mundësuar monitorimin e aktivitetit të institucioneve nga jashtë. Ajo mban evidencën e plotë të gjithë procesit të prokurimit, nga fillimi deri në dhënien e kontratës. Po ashtu, kur kërkohet me shkrim nga çdo palë e interesuar, autoriteti kontraktues siguron qasje të arsyeshme në të dhënat lidhur me aktivitetet e prokurimit, përveç informacioneve sekrete afariste. Pas përfundimit të një aktiviteti të prokurimit, Zyra e Prokurimit siguron qasje të arsyeshme në dokumentet publike për aktivitetet e caktuara, përveç informacioneve sekrete afariste të këruara nga vetë operatorët ekonomikë.

Zyra inkurajon konkurrencën dhe siguron respektimin e barazisë së pjesëmarrësve në procesin e prokurimit publik. Ajo realizon kërkesat e drejtiveve të përputhje me planifikimin e prokurimit dhe, në konsultim me departamentet përkatëse, përgatit planin vjetor të prokurimit për Komunën e Kaçanikut. Zyra raporton në mënyrë periodike te Kryetari i Komunës për aktivitetin e saj dhe përgatit një Raport vjetor për kontratat e nënshkruara në fund të çdo viti fiskal. Ajo asiston në harmonizimin e rregulloreve komunale që lidhen me Ligjin e Prokurimit Publik dhe realizon procesin e pranimit dhe realizimit të kërkesave nga drejtoret.

Përgatit procedurat e prokurimit, përfshirë dokumentet e parakualifikimit, dosjen e tenderit, kushtet e kontratës, raportet e vlerësimit të tenderëve, dhënien e kontratës dhe njoftimet për publikim në KRPP. Zyra organizon dhe menaxhon takime para-ofertuese, hapjen e tenderëve, procesin e vlerësimit, si dhe përgatitjen e raporteve përkatëse. Ajo përgatit kontratat në përputhje me ofertat e shpërblyera dhe koordinon menaxhimin e kontratave me Komisionet mbikëqyrëse. Gjithashtu, përgatit raporte për KRPP dhe për Menaxhment, pranimin e kërkesave nga palët dhe përgjigjen ndaj tyre brenda afateve të caktuara. Zyra gjithashtu pranoni faturat, raportet e mbikëqyrjes dhe raportet e pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve, duke siguruar procesimin e pagesave përkatëse.

Sipas këtij përshkrimi, fushat e rrezikut të identikuara në plan janë: Prokurimi publik nuk është planifikuar sipas nevojave të zhvillimit, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet departamenteve përkatëse, përgatitja joefikase e ofertave të tenderëve, mungesa e protokolleve të qarta për komunikimin me ofertuesit dhe mungesa e kontrollit të kualitetit mbi implementimin e kontratave.

Në gjysmën e dytë të vitit 2023, Zyra e Prokurimit ka vazhduar me publikimin e kontratave në faqen e internetit të prokurimit publik dhe atë komunale. Kështu, duke ndjekur parimin e transparencës, janë ofruar informacione të nevojshme për të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga kjo zyrë, siç janë përcaktuar më sipër.

Administrata Komunale

Për të siguruar që kompetencat ligjore të zbatohen në përputhje me standartet më të larta administrative dhe profesionale, administrata e Komunës së Kaçanikut, në përputhje me nenin 78 të Statutit të Komunës së Kaçanikut (teksti i spastruar sipas Statutit Nr. 01.Nr.60/01-12895/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të

Komunës së Kaçanikut Nr. 01.Nr.3588/2008, datë 25/09/2008), përbëhet nga drejtori të ndryshme, të cilat janë si më poshtë:

- 1.1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- 1.2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- 1.3. Drejtoria e Arsimit;
- 1.4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
- 1.5. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- 1.6. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
- 1.7. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
- 1.8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 1.9. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Kuvendi i Komunës, në raste të nevojshme, mund të krijojë drejtoritë e tjera për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të komunës, pas propozimit të kryetarit dhe në përputhje me këtë rregullore dhe organogramin komunal.

Fushat e rrezikut që mund të shfaqen në këtë segment përfshijnë: rreziqet që lidhen me ofruesit e shërbimeve logistike, të cilat nuk janë adresuar si duhet; performanca e dobët e Qendrës për Shërbime të Qytetarëve; dhe menaxhimi i dobët i të dhënave.

Me ndarjen e duhur të drejtorive dhe sektorëve në administratën komunale, është mundësuar krijimi i një sistemi efikas për menaxhimin e shpenzimeve, kontratave dhe përmirësimin e performancës së Qendrës për Shërbime të Qytetarëve.

Konflikti i interesit

Konflikti i interesit ndodh kur ka një mospajtim ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur ky zyrtar ka një interes privat, direkt ose indirekt, që mund të ndikojë ose duket se ndikon në mënyrën e realizimit të gabuar të funksionit publik, duke shkaktuar mundësi për shkelje të parimeve, kufizimeve ose detyrimeve të tjera zyrtare. Me qëllim parandalimin e këtyre situatave, planifikimi i integrititetit përfshin informimin e zyrtarëve mbi rastet kur mund të ndodhë një konflikt interes. Në këtë kuadër, është miratuar vendimi për emërimin e një personi përgjegjës për menaxhimin e konflikteve të interesit brenda komunës, i cili gjatë periudhës raportuese nuk ka raportuar asnjë rast të tillë.

Mospërputhja e funksioneve

Mospërputhja e funksionit është situata kur një profesionist që mban një pozita zyrtare angazhohet në profesione ose aktivitete të tjera që synojnë të sigurojnë të ardhura, pa miratimin paraprak të punëdhënësit, përveç aktiviteteve pedagogjike, shkencore, hulumtuese, artistike, kulturore, sportive, botuese ose aktiviteteve të tjera që parashikohen nga ligje të ndryshme.

Në lidhje me këtë fushë rreziku, duhet theksuar se në administratën komunale, të gjithë zyrtarët publikë e kryejnë punën e tyre në përputhje me standarde profesionale dhe nuk ka raste të mospërputhjes së funksionit. Çdo zyrtar publik

vepron sipas kushteve të akt-emërimit dhe përshkrimit të detyrate të punës. Në disa raste, zyrtarët publikë mund të realizojnë detyra shtesë, por këto nuk kalojnë 10% të angazhimit të përgjithshëm të tyre. Çdo drejtorat dhe sektor janë të parashikuar në organogram dhe çdo zyrtar ka një zëvendës për t'u angazhuar në rast të mungesës ose pushimit. Kjo siguron që qytetarët dhe zyrtarët publikë të kenë qasje të pandërprerë në shërbime dhe që puna të zhvillohet pa probleme dhe në mënyrë konsistente.

Deklarimi i pasurive

Mospërputhja e deklarimit të pasurisë së kërkuar është situata kur një profesionist që mban një pozita zyrtare, i kërkohet me ligj të raportojë dhe të komunikoje pasuritë e tij/saj te autoritetet përkatëse, pas marrjes ose ndërprerjes së detyrës publike.

Nga të dhënët zyrtare që disponojmë, kjo çështje rregullohet përmes Agjencisë Kundër Korrupsionit. Si pasojë, të gjithë zyrtarët që mbajnë pozita publike dhe kanë obligimin të deklarojnë pasurinë e bëjnë këtë në mënyrë të rregullt, pa ndonjë problem gjatë periudhës raportuese. Po ashtu, për menaxhimin e procesit të deklarimit të pasurisë, është caktuar një person përgjegjës.

Kabineti i Kryetarit

Në fushën e rrezikut që lidhet me Kabinetin e Kryetarit, rreziku potential është përcaktuar si pasojë e mungesës së resurseve adekuate për stafin e kabinetit, mosrespektimit të plotë të zinxhirit komandues dhe mungesës së mekanizmit të ankesave, etj.

Kryetari i Komunës ka siguruar që kabineti i tij të përbëhet nga individë të kualifikuar, profesionistë dhe të pranueshëm, duke krijuar një njësia pune të favorshëm ku secilit i ndahen përgjegjësitë. Të gjithë janë të gatshëm të ndihmojnë njëri-tjetrin për të arritur objektivat e caktuara nga ai.

Bashkëpunimi ndërsektorial dhe ndërdrejtoror ka sjellë rezultate pozitive, duke përfshirë përmirësimin e performancës së përgjithshme të komunës, dëgjinin e kërkeshave dhe ankesave të qytetarëve, dhe aplikimin e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Pra, kabineti i kryetarit është i detyruar të funksionojë si një trup i bashkuar, me qëllimin që zhvillimi i politikave lokale të jetë në përputhje me kërkeshat e qytetarëve dhe të ofrojë përgjigje të shpejtë e efektive në çdo moment. Nga ana tjetër, delegimi i kompetencave te stafi mbështetës, si drejtorët e drejtorive komunale, është thelbësor për rritjen e performancës dhe efikasitetit në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.

Licencimi i shërbimeve publike dhe i objekteve

Në këtë fushë, përkufizimi kryesor i rrezikut lidhet me mungesën e efikasitetit në licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, si dhe me kontrollin e

pamjaftueshëm të faktorëve kryesorë të rrezikut, të tillë si: menaxhimi dhe realizimi i projekteve kapitale, efikasiteti i organizimit të transportit publik të udhëtarëve, fondi i pamjaftueshëm për situata emergjente, menaxhimi i pamjaftueshëm i rrezikut në trajtimin e mbeturinave, mungesa e kapaciteteve të stafit në ofrimin e shërbimeve publike dhe procedurat administrative.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike është organi përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike. Sipas raportit të vitit 2023, kjo drejtori ka arritur me sukses objektivat e saj, me fokus të veçantë në realizimin e projekteve kapitale, transportin publik, menaxhimin e mbeturinave dhe reagimin ndaj situatave emergjente, duke siguruar një stabilitet të plotë në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Inspektimi

Udhëheqësi i zyrës së Inspektoratit udhëheq me zyrën e Inspektoratit, e cila përbëhet nga inspektorët komunal të caktuar me akt-emërime. Zyra e Inspektoratit është përgjegjëse për realizimin e detyrave të mëposhtme: Mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera në fushat e ndërtimit, tregut, sanitarisë, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban, hidroekonomisë, rrugëve, etj.; Implementimin e praktikave të inspektimit të tregut, duke përfshirë shitjen ilegale të mallrave, kontrollin e afatit të përdorimit të artikujve dhe respektimin e orarit të punës për bizneset; Sigurimin e mbrojtjes efektive të konsumatorëve përmes inspektimit të artikujve ushqimorë, mishit, shpezëve dhe produkteve të qumështit; Sigurimin e standardeve të larta në fushën e mbrojtjes së ambientit, kushteve sanitare dhe higjenës publike, përfshirë inspektimin e cilësisë së ujit dhe metodat e hedhjes së mbeturinave; Mbikëqyrjen e implementimit të Planeve Zhvillimore të Komunës, planeve urbane dhe rregulluese, përfshirë kushte të ndërtimit, rikonstruimin e objekteve industriale, banesore dhe infrastrukturës komunale; Zbatimin e inspektimit në lëmin e ndërtimit dhe rindërtimit për të siguruar përputhshmërinë me rregullat dhe parandalimin e ndërtimit ilegal; Inspektimin e shërbimeve komunale, me fokus në transportin publik dhe objektet e tij; Ekzekutimin e vendimeve dhe marrjen e masave ligjore ndaj operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore; Përgatitjen e aksioneve për eliminimin e të metave në bashkëpunim me organet kompetente si policia, gjykata dhe prokuroria.

Në fushat e rrezikut që lidhen me funksionimin e inspektoratit, fokus i veçantë duhet të jetë: resursimi i pamjaftueshëm i inspektimit, mungesa e inspektimeve të rregullta, organizimi i paefektshëm i sistemit të inspektimit, dhe mungesa e implementimit të planeve të inspektimit.

Me krijimin e Zyrës së Inspektoratit si pjesë e Zyrës së Kryetarit, inspektimi ka marrë një rol të rëndësishëm në eliminimin e faktorëve që mund të dëmtojnë integritetin e institucioneve, veçanërisht në fushën e inspektimeve. Sipas raportit të kësaj zyre për periudhën e raportuar, është e dukshme se ky segment ka ndihmuar në mbrojtjen dhe promovimin e integritetit.

Urbanizmi dhe Planifikimi

Urbanizmi dhe planifikimi janë përgjegjësi që i takojnë Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Kjo drejtori është përgjegjëse për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Planifikimi i zhvillimit hapësinor dhe urbanistik, monitorimi dhe studimi i zhvillimit hapësinor të komunës, duke përdorur metodologjinë bashkëkohore;
- Hartimi i programeve, planit zhvillimor të komunës, planit zhvillimor urban dhe planeve rregulluese urbane për vendbanimet dhe tërësitë e tjera;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me të gjitha palët e përfshira në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të qytetit dhe komunës gjatë hartimit të planeve hapësinore;
- Përgatitja e planeve të detajuara urbanistike dhe projekteve urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe pjesë të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Hartimi i programeve dhe detyrave projektuese me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur, për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- Ofrimi i informacionit dhe dokumenteve të nevojshme për përgatitjen, miratimin ose ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe komunës;
- Përcaktimi i kushteve urbanistike dhe arkitektonike për hartimin e dokumentacioneve investivo-teknike për ndërtimin e objekteve dhe realizimin e projekteve kryesore urbanistike;
- Propozimi dhe miratimi i kritereve për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës.

Në këtë fushë, sipas planit komunal për integritet, rreziku potencial është identifikuar si mungesa e kontrollit, ndërkohë që janë identifikuar edhe faktorë të tjera, si:

- Plani i zhvillimit nuk është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Hapësinor;
- Mungesa e ndërgjegjësimit dhe transparencës në çështjet e zhvillimit urban;
- Kanalet e dobëta për marrjen e reagimeve nga aktorët e jashtëm.

Gjatë periudhës raportuese, fusha e Urbanizmit dhe Planifikimit ka qenë në procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartave Zonale, dokumente të cilat do të kontribuojnë në krijimin e infrastrukturës moderne për zhvillimin e Komunës së Kaçanikut.

PËRMBLEDHJE

Plani Komunal për Integritet 2024-2026 është një dokument që përcakton mënyrën e forcimit dhe ruajtjes së integritetit në institucionet e Komunës së Kaçanikut. Përveç fushave specifike të rrezikut të cilat janë raportuar për shkak të rëndësisë së tyre, ka edhe shumë aspekte të tjera që janë thelbësore për funksionimin e mirë të Komunës.

Kontrolli, disiplina, shpërndarja e përgjegjësive, parimi i subsidiaritetit dhe llogaridhënia janë detyra të përditshme që synojnë realizimin e reformave graduale në administratën publike, me qëllim përafshimin me standartet e Bashkimit Evropian.

Komuna e Kaçanikut ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë e angazhuar për të shërbyer qytetarëve, me një fokus të veçantë në përmirësimin e integritetit institucional.

Në përfundim, Komuna e Kaçanikut do të vazhdojë të hartojë akte dhe masa që forcojnë mekanizmat kontrollues, me qëllimin e ngritjes dhe promovimit të integritetit. Pavarësisht sfidave dhe dukurive negative që ndodhin në shoqërinë tonë, Komuna do të mbetet e angazhuar për të mbështetur këtë përpjekje.

